



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

P.nr.101/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, në çështjen penale ndaj të pandehurit J. S. nga fsh. T., K. Lipjan të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP/II.nr.7552/2018 të dt. 05.02.2019, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur për dhënien e urdhërit ndëshkimor, jashtë seancës gjyqësore, me dt.07.03.2019 merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Prishtinë, PP/II.nr. 7552/2018 të dt.05.02.2019 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të pandehurit:

J. S., nga i ati Ismajl, i lindur më *data e lindjes...*, në Lipjan, kurse jeton në fsh. T., K. Lipjan, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr.persoanl *numri personal...*, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës .

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 06.12.2018, rreth orës 18:12 min, në rrugën magjistrale Prishtinë-Ferizaj, më saktësisht në fshatin K. KK Lipjan, i pandehuri ka shkel nenin 53 par.1, të ligjit për Rregullat e trafikut rrugor, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e tipit “Mercedes 201”, me targa të regjistrimit *numri i tabelës...*, nga pakujdesia duke menduar me mendje lehtësi se deri te aksidenti nuk do të vij, ka rrezikuar komunikacionin dhe ka vu në rrezik jetën e njerzve, sepse me të arritur në fshatin Konjuh, i pandehuri Jakup Sahitolli duke mos ia përshtatë shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave të krijuara në komunikacion, me pjesën e parë ballore të anës së djathtë të automjetit të tij e godet në pjesën e pasme automjetin (traktorin) e tipit “IMT 542”, të cilin në momentin kritik e drejtonte M. J., ku si pasoj e këtij aksidenti përveç dëmeve materiale, dëmtime me pasoja të përkohshme për shëndetin ka pësuar i dëmtuari M. N. në formë të dërmishjes dhe gërvishjes së lëkures në regjionin ballor të kokës dhe përdredhje të indeve të bua të qafës,-

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, në konform dispozitave të neneve 1, 2, 3, 4, 6, 17, 23, 41, 42, 43, 46, 73, 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe neneve 493, 495 dhe të KPPK-së, të pandehurin e dënon me,

DENIM ME GJOBË

Në shumë prej **200-€** (dyqindëeuro), të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj, në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë konfrom nenit 46 par. 3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

I dëmtuari: M. N.nga fshati V., K.Lipjan, udhëzohet që kërkesen pasurore juridike ta realizojë në procedurë të rregulltë civile.

DETYROHET i akuzuari në emër të shpenzimeve të procedurës shumë prej 60.88-€, në emër të paushallit gjyqësor te ia paguajë shumë prej 20-€, si dhe shumen prej 30-€ ne Fondin e Viktimave të Krimit, këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj, PP/II.nr.7552/2018 të dt.05.02.2019, e ka akuzuar të pandehurin J. S., për shkak të veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe njëkohësisht ka kërkuar që të pandehurit ti shqiptohet urdhër ndëshkimor – dënim me gjobë për veprën e lartcekur penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi shqyrtoi provat që i janë bashkangjitur aktakuzës respektivisht kallëzimit penal të dt.06.12.2018, mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko-ligjor të Dr. V. H., i dt:22.01.2019, si dhe mendimi i ekspertit të komunikacionit Ingj. A. M. i dt:22.01.2019, si dhe foto dhe dokumentacioni dhe shkresat tjera të lëndës, erdhi në përfundim se ka prova të besueshme nga kallximi penal lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës, në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se “Për vepra penale e cila parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në 3 (tre) vite, për të cilat prokurori i shtetit është i informuar me provat e besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do ti shqiptoi dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor”.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor ndaj të akuzuarit nga arsyet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i akuzuari është dënim me gjobë apo me burgim deri në 3 (tri) vite, andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 450 par. 2 nën par. 2.1. dhe nën par. 2.6 të KPPK-së, ku në këto shpenzime janë llogaritur shuma prej 40.88-€ për ekspertizë të komunikacionit, shuma prej 20-€ për ekspertizë mjeko-ligjore dhe shumë prej 20-€ në emër të paushallit ndërsa vendimi për pagesën e shumës në Fondin e Viktimave të Krimit u bazu në nenin 39 të Ligjit për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore- juridike, u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN

P.nr.101/19, me dt.07.03.2019

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë në kundërshtim në afat prej 8 (tetë) dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit, kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate.